



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**MBI DETYRIMIN E EMETUESIT PËR INFORMIMIN E PUBLIKUT
MBI FAKTET ME RËNDËSI MATERIALE**

Miraturar me vendimin e Bordit nr. 42, Datë 28.05.2009

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së dhënies dhe të përmbajtjes të informacionit që i duhet dhënë publikut në lidhje me rrethana apo vendime të cilat përbëjnë fakte me rëndësi materiale si dhe përcaktimi i rasteve që përbëjnë fakte me rëndësi materiale.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 95 dhe 96 të Ligjit Nr. 9879, datë 21.02. 2008 “Për Titujt”, dhe në përputhje me Ligjin Nr.9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

**Neni 3
Detyrimi për informim**

Emetuesi duhet të informojë menjëherë publikun për të gjitha informacionet që lidhen me rrethana apo ngjarje të cilat përbëjnë fakte me rëndësi materiale, fakte të cilat ndikojnë në çmimin e titujve në treg.

**Neni 4
Subjektet në zbatim**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjithë emetuesit sipas nenin 5 të ligjit 'Për titujt', të cilët janë të regjistruar në bursë.

Neni 5

Fakte me rëndësi materiale

Fakte me rëndësi materiale konsiderohen rastet e mëposhtme:

1. Ecuria e biznesit;
2. Ndryshimi i paketës kontrolluese dhe marrëveshje në lidhje me këtë paketë;
3. Ndryshime në bordin e drejtorëve dhe të këshillit të mbikëqyrjes;
4. Ndryshime të auditorëve dhe çdo informacion në lidhje me aktivitetin e tyre;
5. Vendimi i asamblesë në lidhje me rritjen apo zvogëlimin e kapitalit fillestar;
6. Vendime të asamblesë të emetuesit për bashkimin dhe ndarjen e shoqërisë apo shpërndarjen e aksioneve;
7. Blerje apo transferim i aseteve nga emetuesi ose nga shoqëritë e kontrolluara prej tij kur:
 - (a) asetet e blera apo të transferuara përfaqësojnë një shumë më të madhe se 15% të vlerës së aseteve të emetuesit ose të aseteve të konsoliduara, sipas rastit siç mund të paraqiten në pasqyrat e fundit financiare të kontrolluara nga eksperti kontabël;
 - (b) asetet janë transferuar apo blerë nga ndonjë drejtor apo drejtor ekzekutiv i emetuesit apo i shoqërive të kontrolluara prej tij, ose nga ndonjë person i lidhur me to;
 - (c) asetet janë transferuar apo blerë nga ndonjë shoqëri tregtare ku aksioneri kryesor është drejtor apo drejtor ekzekutiv i emetuesit ose i shoqërive të kontrolluara prej tij, apo, është person i lidhur me to.
8. Kur asetet e transferuara nga emetuesi ose nga shoqëritë e kontrolluara prej tij, realizojnë një fitim neto para tatimit në një masë më të madhe se 15% e fitimit para tatimit të realizuar nga mjetet e konsoliduara të paraqitura në pasqyrat e fundit financiare të kontrolluara nga ekspertët kontabël.
9. Vendime për strukturime apo organizime të reja të shoqërisë të cilat mund të ndikojnë në asetet, përgjegjësitë, pozitën financiare ose humbjet apo fitimet e emtuesit;
10. Politika investimi apo transaksione për riblerjen e instrumentave të tjerë financiarë të listuar;
11. Ndryshime në kategorinë e të drejtave të aksioneve të listuara të emetuesit;
12. Shpallja e falimentimit;
13. Çështjet gjyqësore në proces të cilat mund të ndikojnë në ecurinë e biznesit;

14. Revokimi apo anulimi i linjës së kreditit nga një ose më shumë banka;
15. Prishja e shoqërisë ose vërtetimi i shkakut të prishjes;
16. Ndryshime në vlerën e asetëve mbi vlerën 10%;
17. Aftësia paguese e debitorëve të caktuar;
18. Zvogëlimi i vlerës së pasurive të paluajtshme;
19. Shkatërrimi fizik i mallrave të pasiguruar;
20. Licenca, patenta dhe regjistrime markash të reja;
21. Zvogëlimi ose rritja e vlerës së instrumentave financiarë të portofolit;
22. Zvogëlimi i vlerës së patentës ose të drejtave apo asetëve të paprekshme si shkak i risive të tregut;
23. Marrja e ofertave për blerje në lidhje me asete të caktuara;
24. Produkte apo procese të reja;
25. Rastet në lidhje më dëme shkaktuar konsumatorit nga përdorimi i mallit të emetuesit;
26. Ndryshime të fitimeve apo humbjeve të pritshme;
27. Ofertat e bërë nga klientët, anulimi i tyre apo ndryshime të tjera të rëndësishme;
28. Tërheqja apo hyrja në një tjetër fushë biznesi;
29. Ndryshime në politikat investuese të emetuesit;
30. Dividentët, ndryshimet në shumën dhe datën e pagimit të tyre, dhe ndryshime në politikat në lidhje me dividendët;
31. Çdo rast tjetër që Autoriteti e shikon si një fakt me rëndësi materiale që ndikon në çmimin e titujve në treg.

Neni 6

Kërkesa shtesë

Në rastet kur zbatohen paragrafët (7) dhe (8) të nenit 3, emetuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe pa vonesë Autoritetin, Bursën, çdo anëtar dhe zotërues të letrave me vlerë të tij dhe publikun e gjërë, për transaksionet e kryera duke përfshirë detajet e mëposhtme:

1. datën dhe palët pjesëmarrëse në transaksion;
2. një përshkrim i përgjithshëm i natyrës së asetëve, nëse këto asete janë tërësisht ose pjesërisht aksione, emrat dhe një përshkrim të përgjithshëm të aktivitetëve të shoqërive që kanë emetuar këto aksione;
3. vëllimin total i paguar si dhe afati i pagesës;
4. në rastin e një transaksioni që i referohet paragrafit (7) (a) ose (b) bazën e vlerësimit të asetëve në momentin e blerjes ose transferimit dhe, në rastin e një transferimi asetesh, tepricën ose defiçitin e të ardhurave të realizuara nga ky transaksion në krahasim me vlerën kontabël;
5. në rastin e një transaksioni të përcaktuar në paragrafin (7) (b) dhe (c), emrin e drejtorit ose drejtorit ekzekutiv apo të personave të lidhur me to:

- a) në rastin e drejtorit ose drejtorit ekzekutiv, postin që mban;
- b) në rastin e personave të lidhur me to natyrën e marrëdhënieve, emrin e atij drejtori ose drejtori ekzekutiv dhe postin e tij.

Neni 7

Mënyra e informimit

Informimi i publikut nga ana e emetuesit kryhet në mënyrë të menjëhershme dhe pa vonesë me anë të publikimit të informacionit në faqen e internetit të emetuesit dhe të Bursës si dhe në 2 (dy) gazeta me qarkullim kombëtar.

Neni 8

Përmbajtja e informacionit

Informacioni i publikuar nga emetuesi duhet të përmbajë në mënyrë sa më transparente, një ose më shumë nga faktet e listuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, të cilat konsiderohen si fakte me rëndësi materiale.

Neni 9

Përjashtimet nga detyrimi për të informuar

Emetuesi nuk e publikon informacionin mbi faktet me rëndësi materiale nëse kjo do të vinte në rrezik interesat e tij të ligjshme, por në këtë rast ai duhet të njoftojë Autoritetin dhe të marrë miratimin e tij, në përputhje me nenin 96, të ligjit “Për Titujt”.

Neni 10

Ineresa të ligjshme

Për efekt të nenit 8 të kësaj rregullore, interesat e ligjshmelidhen me rrethanat e mëposhtme :

1. negociata në vazhdim, ose veprimtari që lidhen me to, rezultati ose ecuria normale e të cilave ka mundësi të ndikohet nga publikimi i informacionit. Në veçanti, kur gjendja financiare e emetuesit është në rrezik të madh dhe të afërt, por jo deri në vënien në likuidimin e shoqërisë, publikimi i informacionit mund të vonohet për një periudhë të kufizuar gjatë së cilës një zbulim i tillë publik do të rrezikonte seriozisht interesat e aksionerëve ekzistues ose potencial duke dëmtuar mbylljen e negociatave për të siguruar kalimin e situatës financiare të emetuesit;

2. vendime të marra ose kontrata të bëra nga një strukturë e caktuar e emetuesit, të cilat kanë nevojë të miratohen nga një strukturë tjetër e emetuesit, me qëllim që të bëhen efektive kur emetuesi është i organizuar në mënyrë të tillë që kërkon ndarjen ndërmjet këtyre strukturave, me kusht që një zbulim publik i informacionit përpara një miratimi të tillë bashkë me njoftimin e njëkohshëm se ky aprovim është akoma pezull, do të rrezikojë vlerësimin korrekt të informacionit nga publiku;
3. çdo rrethanë tjetër që konsiderohet e lidhur me interesa të ligjshme.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datëne publikimit në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Elisabeta Gjoni
KRYETAR

